

AKT THEMELIMI

**I SHOQËRISË TREGTARE ME
PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

"QUANTUMX SYSTEMS" SH.P.K.

Në Tiranë, sot me datë 03.07.2024,
(dymijë e e njezet e katër), unë i nënshkruari i
mëposhtëm:

- **TAN CHOON TEIK**, i datëlindjes 10.06.1981,
lindur në Pulau Pinang Malajzi dhe banues në
Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike dhe
për të vepruar, i identifikuar me pasaportën Nr.
A55477083 dhe Nr personal identifikimi
810610075873,

*me cilësinë e "Ortakut Themelues", redaktoj këtë akt
themelimi, nëpërmjet të cilit deklaroj se me vullnet
të lire, të plote e të sigurtë, dhe inisiativen e lirë
private, mbështetur në Kushtetutën e Republikës së
Shqipërisë dhe Kodin Civil në fuqi, në ligjin 9901
datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë
Tregtare", me ndryshimet përkatëse, në ligjin "Për
QKB", në Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, krijoj
shoqërinë tregtare, me përgjegjësi të kufizuar, me
emërtimin "QuantumX Systems" sh.p.k.*

KREU I

**Emertimi, Forma Juridike, Selia, Kohezgjatja,
Objekti**

**Neni 1
Emertimi**

Emërtimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar
është **"QuantumX Systems" sh.p.k.**

MEMORANDUM OF ASSOCIATION

**OF THE LIMITED LIABILITY TRADE
COMPANY**

"QUANTUMX SYSTEMS" SH.P.K.

In Tirana, this day of 03.07.2024, (two
thousand and twenty-four), I, the undersigned:

- **TAN CHOON TEIK**, born on 10.06.1981 in
Pulau Pinang Malaysia and resident in Tirana, adult
with full legal capacity to act, identified with
passport No. A55477083 and personal
identification number 810610075873,


*in the capacity of "Founding Partner", I edit this
Memorandum of Association, through which I
declare that with free will, full and sincere, and free
private initiative, based on the Constitution of the
Republic of Albania and the Civil Code in force, in
the law 9901 dated 14.04.2008, "On Merchants and
Trading Companies", with the relevant
amendments, in the law "On NBC", in the Customs,
Fiscal and Tax Code, I create the trading company,
with limited liability, with the name "QuantumX
Systems" sh.p.k.*

CHAPTER I

**Name, Legal Form, Headquarters, Duration,
Scope**

**Article 1
Company name**

The name of the limited liability company is
"QuantumX Systems" sh.p.k.



**Neni 2
Forma Juridike**

Shoqëria "QuantumX Systems" sh.p.k., është person juridik i të drejtës shqiptare, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë e quajtur "Shoqëria"), e themeluar nga personi fizik i sipërpërmendur, i cili nuk përgjigjet për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulon personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkuara.

Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

**Neni 3
Selia**

Shoqëria e ka selinë në, Tiranë Rr. "Dervish Hima", Pallati Ambasador, Hyrja 1. Ap 74, zona kadastrale 8160, vol 47, faqe 41, nr pasurie 6/410+1-185 Tiranë.

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, degë, të krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

**Neni 4
Objekti**

Aktiviteti në fushën e zhvillimit të softuerit, zhvillim i ciklit të plotë të dizajnit, të marketingut digjital, të aplikacioneve mobile dhe aplikacioneve web dhe mirëmbajtjes së tyre, integrim i sistemeve të treta, përpunim dhe çdo shërbim softueri për bizneset dhe klientët.

**Article 2
Legal form**

The company "QuantumX Systems" sh.p.k., is a legal entity under Albanian law, a Limited Liability Company (hereinafter referred to as the "Company") founded by the aforementioned natural person, who is not liable for the obligations of the commercial company and personally covers the losses of the company up to the outstanding part of the signed contributions.

The company acquires legal entity after being registered in the National Registration Center, in accordance with the conditions and procedures provided by law.

The company, after having acquired legal entity, is responsible to third parties for the obligations and damages caused during its activity.

**Article 3
Headquarters**

The company is headquartered in Tirana, Rr. "Dervish Hima", Pallati Ambasador, Hyrja 1. Ap 74, cadastral area 8160, vol 47, page 41, property no. 6/410+1-185 Tirana.

The company can change its headquarters, open representative offices, branches, create subsidiaries, both inside and outside the Republic of Albania, only by decision of the Assembly of Partners.

**Article 4
Scope**

Activity in the field of software development, development of the full cycle of design, digital marketing, mobile applications and web applications and their maintenance, integration of third-party systems, processing and any software services for businesses and customers.

**Neni 5
Kohëzgjatja**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit në QKB.

**KREU II
KAPITALI**

**Neni 6
Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar i shoqërisë është **5.000.000 (pesë milion) lekë** dhe është i përbërë **1 kuotë**.

Kapitali i regjistruar i Shoqërisë është tërësisht i nënshkruar, i papaguar, ndahet në 1 kuotë me vlerë, që përbën 100% të kapitalit të shoqërisë, që zotërohet nga Ortaku i shoqërisë të ndarë në një kuotë, si më poshtë:

- 1- TAN CHOON TEIK**, zotëruesi i 1 kuote, që përbën 100 % të kapitalit të përgjithshëm të shoqërisë, me vlerë të përgjithëshme **5.000.000 (pesë milion) lekë**.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme. Kontributi i ortakeve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta)
Ortaku, që pengohet të ushtrojë të drejtat që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cenimit apo shpërblimin e dëmit të shkaktuar, si pasojë e cenimit të këtyre të drejtave. Kjo e drejtë parashkruhet brenda 3 vjetëve nga çasti i cenimit.

**Neni 7
Transferimi i kapitalit**



**Article 5
Duration**

The company will develop its activity for an unlimited period of time, starting from the date of registration in the National Business Center.

**CHAPTER II
Registered Capital**

**Article 6
Registered Capital**

The registered capital of the company is **ALL 5,000,000 (five million)** and consists of 1 quota.

The registered capital of the Company is fully subscribed, unpaid, divided into 1 quota of value, which constitutes 100% of the capital of the company, owned by the Partner of the company divided into one quota, as follows:



- 1- TAN CHOON TEIK**, the owner of 1 quota, which constitutes 100% of the total capital of the company, with a total value of **ALL 5.000.000 (five million)**.

Shares of the share capital cannot be represented by marketable securities.

The contribution of partners can be in cash or in kind (movable/immovable assets or rights)

The partner, who is prevented from exercising the rights derived from the ownership of the company's quota, has the right to ask the court to order the prohibition of the violation or the compensation of the damage caused as a result of the violation of these rights. This right is prescribed within 3 years from the moment of infringement.

**Article 7
Transfer of capital**



Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Ky statut kushtëzon kalimin e kuotave të tretëve jashtë shoqërisë, me miratimin e shoqërisë dhe të drejtën e parablerjes në favor të shoqërisë apo të ortakëve të tjerë, sipas modaliteteve dhe shumicës së cilësuar që kërkon ndryshimi i statutit.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të saj në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE

Neni 8 Organi Vendimmarrës

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

The capital quotas of a limited liability company and the rights derived from them can be acquired or transferred through:

- a) contribution to the capital of the company,
- b) sale and purchase;
- c) inheritance;
- ç) donation;
- d) any other way provided by law.

In the case of contractual transfer of quotas, the contract must be made in writing.

This instrument stipulates the transfer of quotas to third parties outside the company, with the approval of the company and the right of pre-emption in favour of the company or other partners, according to the modalities and the qualified majority that requires the change of the Articles of Association.

The person who passes the quota and the one who earns it are jointly and severally liable to the company for the obligations arising from the possession of the quota, from the moment of the quota transfer, until the moment of registration of its transfer at the National Registration Center, according to Article 43 of law no. 9723, dated 3.5.2007 "On National Registration Center". The registration of the transfer of quotas has a declarative effect.

Shares of the registered capital are freely transferable between partners.

Shares of the registered capital are freely transferable through inheritance.

CHAPTER III DECISION-MAKING AND MANAGEMENT BODIES

Article 8 Decision-Making Body

The Assembly of Partners is the sole decision-making body of the company.

The Assembly of Partners is the only decision-making body of the company that approves any changes to the Articles of Association according to the modalities defined in the law.

The general assembly of partners is responsible for making decisions for the company on the following issues:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) ndryshimet e statutit;
 - c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
 - ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
 - dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
 - f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
 - i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
- Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 9 Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë, vendos me votat e te pakten tri të katërtave të zotëruesve të kapitalit të shoqërisë, që janë pjesëmarrës në mbledhje.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si :

- a) determining the commercial policies of the company;
- b) changes to the Articles of Association;
- c) appointment and dismissal of administrators;
- ç) appointment and dismissal of liquidators and authorized accounting experts;
- d) determining the rewards for the persons mentioned in the letters "c" and "ç" of this point;
- dh) supervision of the implementation of commercial policies by administrators, including the preparation of annual financial statements and activity progress reports;
- e) approval of annual financial statements and activity progress reports;
- ë) capital increase and decrease;
- f) allocation of quotas and their cancellation;
- g) representing the company in court and in other proceedings against administrators;
- gj) reorganization and dissolution of the company;
- h) approval of the procedural rules of assembly meetings;
- i) other issues provided by law or Articles of Association.

The partner can be represented in the general assembly, based on an authorization from another partner or from a third person.

The administrator of the company cannot act as a representative of the partners in the general assembly.

Authorization can only be given for one meeting of the general assembly, which also includes subsequent meetings with the same agenda.

Article 9 Decision-making

The general assembly decides with three-fourths of the votes of the capital owners, of the participating partners, on the change of the Articles of Association, the increase or decrease of the registered capital, the distribution of profits, the reorganization and the dissolution of the company.

The general assembly decides with the majority of votes of the participating partners, on other issues such as:

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
 - c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - ç) përcaktimin e shpërblimeve
 - d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasyqruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

Neni 10 Administrimi

Shoqëria do të administrohet nga një administrator. Administrator i shoqërisë do të jetë **Z. TAN CHOON TEIK** i cili do të ushtrojë funksionet në këtë detyrë për një periudhë **5 vjecare me të drejtë ripërtëritje**.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Statuti, apo marrëveshje të tjera nuk mund të përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë. Përveç kësaj, administratori shkarkohet nga gjykata për shkelje të ligjit me kërkesë të çdonjërit prej ortakëve.

Tagrat e përfaqësimit të administratorit do të jenë të pakufizuara dhe çdo ndryshim i tyre njoftohet për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit. Administratorët mund të përfaqësojnë shoqërinë së bashku ose veç njëri nga tjetri dhe mund të prokurojnë të tretë për përfaqësim të tyre. Emërimi i administratorit prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

- a) determining the commercial policies of the company;
 - b) appointment and dismissal of administrators;
 - c) appointment and dismissal of liquidators and authorized accounting experts;
 - ç) determination of rewards
 - d) supervision of the implementation of commercial policies by administrators, including the preparation of annual financial statements and activity progress reports;
 - e) representing the company in court and in other proceedings against administrators;
 - f) approval of the procedural rules of assembly meetings;
- Any changes to the Articles of Association must be filed with the NBC to reflect the changes in the company's file.

Article 10 MANAGEMENT

The company will be administered by an administrator.

The administrator of the company will be **Mr. TAN CHOON TEIK** who will exercise the functions in this position for a period of **5 years with the right of renewal**.

The general assembly may dismiss the administrator at any time by a simple majority. The Articles of Association or other agreements cannot exclude or limit this right.

In addition, the administrator is dismissed by the court for violation of the law at the request of each of the partners.

The administrator's representation fees will be unlimited and any changes to them are notified for registration at the National Registration Center. Administrators can represent the company together or separately from each other and can procure third parties for their representation.

The appointment of the administrator produces effects after registration at the National Registration Center.

**Neni 11
Kompetencat**

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
 - b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
 - c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
 - ç) përgatit dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
 - d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
 - dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
 - e) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- Administratori është i detyruar të thërrasi asamblenë e përgjithshme edhe në rastet kur :

- Asambleja e përgjithshme thirret pasi, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe

- kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuar,

Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e

**Article 11
Competencies**

The administrator has the right and is obliged to:

- a) carry out all actions of the administration of the commercial activity of the company, implementing the commercial policies, decided by the general assembly;
 - b) represent the commercial company;
 - c) takes care of the correct and orderly keeping of the company's documents and accounting books;
 - ç) prepare and sign the annual balance sheet, the consolidated balance sheet and the activity progress report and, together with the proposals for the distribution of profits, present these documents to the general assembly for approval;
 - d) create a timely warning system for circumstances that threaten the smooth running of the activity and the existence of the company;
 - dh) perform the registrations and send the mandatory data of the company, as provided for in the law on the National Registration Center;
 - e) report before the general assembly regarding the implementation of commercial policies and the realization of special actions of special importance for the activity of the commercial company;
- The administrator is obliged to call the general assembly also in cases where:

- The general assembly is called after, according to the annual balance sheet or interim financial reports, it results or there is a risk that the assets of the company do not cover the liabilities that can be requested within the next 3 months and

- when the company, within the first 2 years after its registration, proposes to buy assets from a partner, which have a value higher than 5 percent of the company's assets, which results in the last certified financial statements,

The administrator has the right to perform all ordinary and extraordinary administration actions. The Administrator represents the Company before all physical and legal persons, public and/or private local or foreign, Albanian or foreign state



juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkalleve. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakeve te shoqerise.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Neni 12 Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 13 Prishja dhe likuidimi

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të asamblesë së përgjithshme;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- d) me vendim të gjykatës;

authorities, including judicial authorities of all levels. The administrator has all the powers to act in relations with third parties on behalf of the company, in all circumstances with the exception of the powers that the law expressly grants to the partners of the company.

The administrator engages the company in relations with third parties through acts that are in accordance with its object.

The company does not assume the consequences against third parties when it proves that the third parties knew that the administrator's act exceeded the scope of the company or when the third parties could not ignore this act in the given circumstances, taking into account the fact that the mere announcement of the Articles of Association shall not be considered an adequate proof.

Article 12 Financial Year

The financial year of the Company begins on January 1 and ends on December 31. Exceptionally, the first financial year starts from the date of the company's registration at the National Registration Center and ends on December 31.

Article 13 Dissolution and liquidation

The dissolution or liquidation of the company can be done at any time:

- a) when the duration provided for in its establishment ends;
- b) by decision of the Assembly of Partners;
- c) with the initiation of bankruptcy procedures;
- ç) in cases when no commercial activity carried out for two years and the suspension of activity has not been notified in accordance with point 3 of article 43 of law no. 9723, dated 3.5.2007 "On the National Registration Center";
- d) by court decision;

Në këtë rast Asambleja e Ortakëve merr vendim me shkrim në të cilin parashikon mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtesë "Shoqëri në likuidim e sipër".

**Neni 14
Baza Ligjore**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

**Neni 15
Mosmarrëveshjet**

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

**Neni 16
Dispozita përfundimtare**

Ky akt themelimi u redaktua në 3 ekzemplarë me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike, në gjuhën shqipe pasi miratohet në parim dhe nen për nen nga ortaku i vetem i shoqërisë tregtare, nënshkruan në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmën e tij origjinale.

**ORTAKU I SHOQËRISË
TAN CHOON TEIK**

In this case, the Partners take a written decision in which they foresee the way of liquidating the company, appointing 1 or several liquidators and marking in every document issued from him the name of the liquidator and the additional title "Company in liquidation in progress".

**Article 14
Legal basis**

The company will develop its activity in full compliance with this Articles of Association and the provisions of Albanian legislation.

Insofar as it is not provided herein, the provisions of the law "On merchants and trade companies", the Civil Code and any other specific law in the Republic of Albania shall be applied.

**Article 15
Disputes**

For disputes that may arise in connection with the implementation or interpretation of these Articles of Association, as well as for any dispute that may arise between the Company and third parties, the Albanian Court will be competent.

**Article 16
Final provisions**

These Articles of Association were drawn up in 3 copies with the same content and legal values, in the Albanian language, as it is approved in principle and article by article by the partners of the commercial company and they regularly sign it in all copies by putting their first name, last name and original signature.

**COMPANY PARTNER
TAN CHOON TEIK**

 TAN CHOON TEIK

